

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil gjyqtarja Mevlide Kosumi Qarri, në çështjen juridike të paditësve Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqësojnë Hestet Mazrekaj dhe Shefqet Hasimi nga Avokatura Shtetërore dhe Hasan Preteni të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Asdren Bytyqi avokat në Prishtinë, kundër të paditurve OJQ “Çohu” me seli në Prishtinë, Lorik Bajrami, Artan Demhasaj përfaqësues i OJQ-së “Çohu” dhe Besnik Boletini nga Qendra e Kosovës për Gazetari Hulumtuese të cilët i përfaqëson i autorizuari Admir Salihu avokat në Ferizaj, për kompensim të dëmit jo material, vlera e kontestit 150,000€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 10.05.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Hudhet si e palejuar padia e paditës Agjencia Kundër Korrupsionit e parashtruar me datë 07.05.2012 kundër të paditurve OJQ “Çohu” me seli në Prishtinë, Lorik Bajrami, Artan Demhasaj përfaqësues i OJQ “Çohu” dhe Besnik Boletini nga Qendra e Kosovës për Gazetari Hulumtuese për kompensim të dëmit jo material.

II. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Hasan Preteni nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurat OJQ “Çohu” me seli në Prishtinë, Lorik Bajrami, Artan Demhasaj përfaqësues i OJQ-së “Çohu” dhe Besnik Boletini nga Qendra e Kosovës për Gazetari Hulumtuese që në mënyrë solidare paditësit Hasan Preteni në emër të shpërblimit të dëmit jo material për shkak të shpifjes në konferencën për media të datës 16.02.2012 në Prishtinë ti paguaj shumën prej 100,000€ me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha në afat prej 15 ditëve prej marrjes së aktgjykimit.

III.OBLIGOHEN paditësit që në mënyrë solidare t’ia kompensojnë të paditurve shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,393.60€ të gjitha në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga Hasan Preteni si drejtor i saj dhe Hasan Preteni me datë 07.05.2012, pranë kësaj gjykate kanë ushtruar padi kundër të paditurve OJQ “Çohu” me seli në Prishtinë, Lorik Bajrami, Artan Demhasaj përfaqësues i OJQ-së “Çohu” dhe Besnik Boletini nga Qendra e Kosovës për Gazetari Hulumtuese, për shkak të shpifjes dhe fyerjes me propozim që në emër të kompensimit të dëmit jo material të detyrohen të paditurit t’ia pa paguajnë paditës Agjencia Kundër Korrupsionit shumën prej 50.000€, ndërsa paditësit të dytë Hasan Preteni shumën prej 100.000€.

Pretendimet e paditësit- Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit

Paditësi i parë Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit me seli në Prishtinë është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën përgatitore të datës 05.06.2017 duke ia dorëzuar ftesën drejtpërdrejtë këtij institucioni, mirëpo në seanca janë përfaqësuar nga avokatura shtetërore, gjegjësisht përfaqësuesit e saj të autorizuar nga ky institucion. Në seancat e mbajtura përfaqësuesit e paditëses fillimisht kanë deklaruar se mbesin si në padinë e ushtruar me shkrim, më tej në seancën e datës 18.04.2018 përfaqësuesi i paditëses deklaroi për arsye se padinë në këtë çështje juridike e ka hartuar dhe dorëzuar në gjykatë Agjencia Kundër Korrupsionit dhe faktin relevant se Avokaturës Shtetërore padia dhe provat relevante nuk i janë dorëzuar deri tash si organ i autorizuar për përfaqësim, këshillim dhe mbrojtje të autoriteteve publike, ka kërkuar nga gjykata që në kuptim të normave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë ta shtyjë këtë seancë në mënyrë që organi i autorizuar përkatësisht Avokatura Shtetërore ti kërkojë dhe ti sigurojë provat përkitazi me këtë çështje juridike. Në vazhdimin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 10.05.2018 i autorizuari i paditësit nga Agjencioni Kundër Korrupsionit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se mbetem në tërësi pranë thëniesve si në seancat e mbajtura posaçërisht në seancën e datës 18.04.2018 në të cilin ka prezantuar Avokati i Përgjithshëm Shtetëror.

Pretendimet e paditësit- Hasan Preteni

Paditësi Hasan Preteni përmes përfaqësuesve të autorizuar si në padinë e ushtruar me shkrim përmes të cilës ka deklaruar se nga data 19.07.2006 është emëruar Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit ku me datë 16.02.2012 në Prishtinë në një konferencë për media të organizuar nga Organizata jo Qeveritare “Çohu” dhe Qendra e Kosovës për Gazetari Hulumtuese (QKGH) të paditurit kanë shpifur kundër tij, kinse paditësi në cilësinë e Drejtorit të AKK-së “ka mbrojtur 7 deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës të cilët e kanë shkelur Ligjin nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, “ka bërë ndërhyrje dhe ka falsifikuar formularët për deklarimin e pasurisë të paraqitur në AKK nga zyrtarët e lartë publik” dhe “ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë.

Me tej thekson se të gjitha këto shpifje të të paditurve janë publikuar në gazetën mujore “Preportr” të muajit prill 2012 dhe atë në faqet 4, 5 dhe 6, kështu që në këtë mënyrë të paditurit kanë fyer paditësin dhe me vetëdije kanë përhapur fakte të pa vërteta për paditësin, kanë sulmuar vlerat e tij personale dhe në këtë mënyrë e kanë dëmtuar rëndë nderin dhe autoritetin e tij personal si dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit. Për shkak të shpifjes dhe publikimit të fakteve të pa argumentuara nga të paditurit, paditësi i dytë dhe anëtarët e familjes së tij kanë përjetuar cenim të personalitetit, integritetit personal, vuajtje psikike si dhe ka përjetuar shqetësim shpirtërorë dhe ulje të kredibilitetit.

Gjithashtu në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se Shpifja e cila është objekt i këtij kontesti është drejtuar ndaj një personaliteti të lartë publik, pozita, funksioni dhe institucioni që ai drejtonte – Agjencia Kundër Korrupsionit dhe besimi ndaj të cilit si drejtues dhe si institucion, pastërtia morale, etike, ligjore dhe zbatimi i pa kompromis i ligjit është bazë fundamentale dhe tipar qenësorë që e karakterizon veprimtarin e këtij institucioni dhe ushtrimin e detyrës si drejtues i saj. Shpifja është e lidhur ngushtë me personalitetin e paditësit Hasan Preteni dhe integritetin e tij dhe nuk mund të kufizohet në kohë apo në mandat, pasi që cenimi i tij nënkupton edhe cenimin e të ardhmes së tij. Me tej shton se të gjitha këto akuza kanë synuar denigrimin e personalitetit të Z. Pretenit dhe institucionit që e drejtonte të cilat janë bërë publikisht dhe janë përcjellë me kallxim penal të ushtruar nga ana e të paditurve tek organet e prokurorisë së Eulexit e cila me njoftimin e dt. 11.05.2012 i ka hedhur në tërësi si të pabazuara, duke vërtetuar ekzistimin vetëm të natyrës së pastër të shpifjes. Deformimi i të vërtetave nga ana e të paditurave, megjithëse ka pasur të gjitha mundësit që më parë të verifikoj faktet lidhur me informacionet dhe dokumentet publike, dëshmon faktin se të njëjtit nuk kanë qenë të interesuar për prezantimin e drejtë dhe të përmbajtur të fakteve por kanë qenë të orientuar drejt për drejtë në cenimin dhe atakimin e personaliteti të udhëheqësit të organizatës shtetërore.

Me qëndrimin zyrtar të organizatës “Çohu” e jo opinioneve personale, të paditurit kanë shpifur ndaj deklaratave të fakteve duke diskredituar dhe dëmtuar personalitetin e paditësit si drejtues i lartë shtetëror. Nga të lartcekurat i propozon gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit të dytë Z. Preteni si të bazuar dhe në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jo material për shkak të shpifjeve që iu kanë bërë të detyrohen të paditurit në mënyrë solidare të paguajnë paditësit të dytë shumën prej 100.000€ me kamate ligjore si dhe pagimin e të gjitha shpenzimeve procedurale. Shpenzimet procedurës kontestimore i kërkoi.

Pretendimet e të paditurve

Të paditurit në përgjigje në padi, në shqyrtimet e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare përmes të autorizuarit të tyre e kanë kontestuar padinë dhe kërkesë padinë e paditësve në tërësi si të pa bazë. Thekson se deri më sot nuk e kemi marr një precizim formal se kjo padi nga paditësi i dytë është precizuar si paditës individual dhe po ashtu ne nuk kemi ndonjë informacion nga avokatura shtetërore se a e kanë pyetur Drejtorin e tanishëm të Agjencisë se a e trashëgon këtë pretendim të paraardhësit të tij.

Nga vet padia shihet se nuk kemi asnjë elaborim rreth pretendimeve të paditësit të paraqitura në padi sa i përket paditësit të parë, mirëpo qysh në fillim të kësaj padie elaborohet biografia dhe pretendimi për paditësin e dytë, çka do të thotë se paditësi i dytë edhe nga vet vulosja e kësaj padie shihet se këtë padi e ka bërë tek një avokat privat dhe i njëjti nuk ka pasur të drejtë ligjore ta përfaqësoj Agjencinë dhe njëkohësisht edhe veten në këtë padi, meqë është në konflikt të pastër interesi. Fakti se në këtë padi paditësi i dytë flet vetëm për veten dhe nuk kemi asnjë argument as një sqarim për paditësin e parë len të kuptohet se i njëjti e ka keqpërdor pozitën e vet meqë nuk e ka një leje apo një autorizim nga bordi i Agjencionit a mund ta përfaqësoj apo jo edhe Agjencionin në këtë kapacitet. Kjo padi është e pa rregullt edhe sa i përket ligjit special kundër shpifjes dhe fyerjes sepse është totalisht i pa qartë dhe

nuk ka asnjë justifikim dhe me përkufizimet që jep ky ligj dhe atë në nenit 6 për barrën e provës sepse nuk është e specifikume askund se me cilin veprim, në cilën deklaratë, në cilin vend, cilat janë elementet mbi të cilat paditësi për veten por edhe për Agjencionin veprimet ose informimin publik të OJQ-së “Çohu” i ka shkaktuar këtë dëm, këto shpifje ose të pavërteta për paditësin. Duke pasur parasysh se gjatë këtyre shqyrtimeve përfaqësuesit e Agjencionit nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim të tillë rreth kësaj kërkesë konsiderojmë se kjo padi është e parregullt dhe si e tillë do të duhej të hudhej.

Më tutje thekson se me datë 06.12.2011 në një prononcim në RTK Drejtori i Agjencisë Hasan Preteni kishte mbrojtur deputet me arsyetimin se nuk e kanë shkelur ligjin, i njëjti në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë kishte thënë se kemi hulumtuar shumë raste përfshirë këto 7 nga të cilat sipas tij bizneset i kishin pasur pasive dhe të njëjtat nuk kishin pasur qarkullim dhe asnjë aktivitetet dhe 99% të rasteve kanë qenë një aktivitetet pasiv i regjistruar dhe kurrë i aktivizuar.

Me datë 16.02.2012 Organizata “Çohu” në konferencën për shtyp kishte reaguar ndaj deklaratës së datës 06.12.2011 ndaj Drejtorit të Agjencisë këtu paditësit të dytë duke e përgënjeshtuar pretendimet e tij se bizneset në fjalë në 99% të rasteve siç kishte deklaruar janë pasive. “Çohu” thotë se 4 nga to kishin qarkullime madje deri në 1000.000€, për këtë paditësi i dytë në KTV tash deklaroi se pavarësisht janë aktive apo pasive ato duhet të deklarohen. Paditësit nuk kanë arritur të sqarojnë se cilat ishin veprimet shpifëse ndaj Agjencionit dhe cilat ishin ndaj paditësit të dytë Hasan Preteni dhe se padia nuk specifikon se kur Hasan Preteni i referohet vetvetes dhe kur i referohet pozitës së tij dhe kur i referohet Agjencionit. Organizata “Çohu” tërë kohën i referohet se si Drejtor i Agjencionit ka vepruar në kundërshtim me rregullat e brendshme duke shkelur kështu ligjin dhe sipas organizatës “Çohu” Hasan Preteni në cilësinë e Drejtorit apo vartësit të tij kanë falsifikuar dokumentet zyrtare duke ndërruar formularët me të cilat ka legalizuar përmbajtje të pa vërtetë. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon gjykatës ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje juridike zhvilloi procedurën e provave duke lexuar korrespondencat me postë elektronike në mes të Hasan Pretenit dhe Agron Behramit si dhe në mes të Besnik Boletinit dhe Hasan Pretenit nga data 10.11.2011, dt.14.11.2011, dt.15.11.2011, dt.17.11.2011, dt.24.11.2011, dt.30.11.2011, dt.23.12.2011, dt.09.02.2012, dt.05.01.2012, dt.11.01.2012 dhe dt.09.02.2012; regjistri për deklarinimin e pasurisë të 7 deputeteve për vitin 2011; komunikata për media e agjencisë kundër korrupsionit e dt. 16.02.2012; raporti specialistik i dt. 02.05.2012; video incizimi i dt. 06.12.2011 në RTK; video incizimi në KTV në emisionin “Interaktiv” datë 03.02.2012; njoftimi Prokurorisë së Qarkut-Eulex të datës 10.05.2012; parashtresa e datës 23.04.2018 e te paditurave edhe me provat e listuara nga numri 1 deri në numrin rendor 26.

Pas administrimit të të gjitha provave së bashku dhe secilën veç e veç konform dispozitës së nenit 8 të LPK-së, gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit të dytë si të pa bazuar.

Faktet

-Se me datë 16.02.2012 në një konferencë për media të organizuar nga Organizata jo Qeveritare “Çohu” dhe Qendra e Kosovës për Gazetari Hulumtuese (QKGH) të paditurit kanë deklaruar se Hasan Preteni në cilësinë e Drejtorit të AKK-së “ka mbrojtur 7 deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës të cilët e kanë shkelur Ligjin nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë duke pohuar se bizneset e tyre kanë qenë pasive në një nga deklaratat e tij dhënë në RTK”, “ka bërë ndërhyrje dhe ka falsifikuar formularët për deklarinimin e pasurisë të paraqitur në AKK nga zyrtarët e lartë publik” dhe “ka bërë shkelje të dispozitave të ligjit nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë. Sipas paditësit Hasan Preteni të gjitha këto shpifje të të paditurve janë publikuar në gazetën mujore “Preportri” të muajit prill 2012 dhe atë në faqet 4, 5 dhe 6, kështu që në këtë mënyrë të paditurit kanë fyer paditësin dhe me vetëdije kanë përhapur fakte të pa vërteta për paditësin, kanë sulmuar vlerat e tij personale dhe në këtë mënyrë e kanë dëmtuar rëndë nderin dhe autoritetin e tij personal si dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit. Më tej paditësi i dytë pretendon se për shkak të shpifjes dhe publikimit të fakteve të pa argumentuara nga të paditurit, paditësi i dytë dhe anëtarët e familjes së tij kanë përjetuar cenim të personalitetit, integritetit personal, vuajtje psikike si dhe ka përjetuar shqetësim shpirtërorë dhe ulje të kredibilitetit.

- Nga korrespondencat me postë elektronike në mes të Hasan Pretenit dhe Agron Behramit si dhe në mes të Besnik Boletinit dhe Hasan Pretenit nga data 10.11.2011 deri më datë 09.02.2012, vërtetohet se lidhur me çështjen e deklarinimit/mos deklarinimit të pasurisë së deputetëve të caktuar i padituri Besnik Boletini nga Qendra e Kosovës për Gazetari Hulumtuese i është drejtuar paditësit Hasan Preteni drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit duke i parashtruar pyetje konkrete se a janë të obliguar zyrtarët e publik të deklarojnë biznesin e tyre, pavarësisht se a është aktiv ai biznes apo nuk ka aktivitet por është i regjistruar në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve si dhe a keni hetuar ndonjë rast të zyrtarëve të lartë publik që nuk e kanë deklaruar/fshehur një pjesë të pasurisë si dhe pyetje tjera në drejtim të deklarinimit/ mos deklarinimit të pasurisë zyrtarëve publik. Ndërsa lidhur me këto pyetje i padituri Hasan Preteni në cilësinë drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit i është përgjigjur.

-Nga Komunikata për Media e Agjencisë Kundër Korrupsionit e dt. 16.02.2012 paditësi Hasan Preteni në cilësinë Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit i kishte quajtur shpifje dhe sjellje të pa moralshme pohimet e organizatës “Çohu” dhe Qendra për Gazetari Hulumtuese të cilat akuzuan Agjencinë se ka falsifikuar formularët e deklarinimit të pasurisë të disa deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

- Nga raporti specialistik i dt. 02.05.2012, konstatohet se paditësi Hasan Preteni me datë të njëjtë ka kërkuar ndihmë mjekësore pranë QKUK-së klinika e psikiatrisë ku i është përshkruar diagnoza depresiv reaktiv me simptoma dy muajt e fundit.

- Nga video incizimet e datës 06.12.2011 në RTK dhe video incizimi në KTV në emisionin “Interaktiv” datë 03.02.2012, vërtetohet se Hasan Preteni është ftuar nga këto dy televizione dhe është intervistuar lidhur me temën deklarimi/mos deklarimi i pasurisë së zyrtarëve publik dhe i njëjti ka dhënë intervistë në lidhje me këtë tematikë në cilësinë e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

- Nga njoftimi i Prokurorisë së Qarkut-Eulex të datës 10.05.2012, vërtetohet se paditësi Hasan Preteni është njoftuar nga ky institucion se për rastin për të cilin është intervistuar si i dyshimtë rasti kundër tij është hedhur poshtë

-Nga parashtresa e datës 23.04.2018 e të paditurve me provat e listuara nga numri 1 deri në numrin rendor 26, vërtetohet se kemi të bëjmë me formularët për deklarimin e pasurisë së disa deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe çertifikatat e bizneseve të tyre.

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Duke vlerësuar padinë e parashtruar nga pala paditëse Agjencioni Kundër Korrupsionit gjykata vlerësoi se kjo padi nuk është e lejuar.

Me Ligjin Civil numër 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes neni 5 par.4 është paraparë *“Autoritetet publike ndalohen nga paraqitja e kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja e ose fyerja”*, në kuptim të kësaj ndalesë ligjore gjykata e hodhi si të pa lejuar padinë e paditëses Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Pas vlerësimit të pretendimeve të paditësit të dytë Hasan Preteni dhe kundërshtimet e të paditurve të parashtruara nga përfaqësuesit e tyre lidhur me shpifjen dhe fyerjen nga të paditurit, gjykata duke ju referuar provave të administruara gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Në mes të palëve ndërgjyqëse asnjëra nga provat e administruara nuk ishte kontestuese, mirëpo kontestuese në mes tyre ka qenë ekzistimi apo mosekzistimi i shpifjes dhe fyerjes, ku paditësi pretendon se nga shpifjet e të paditurve, ka pësuar dëm jo material duke ia cenuar integritetin personal, vuajtje psikike si dhe ka përjetuar shqetësim shpirtëror dhe ulje të kredibilitetit.

Me Ligjin Civil numër 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes, neni 5 par. 4 fjalia e dytë parashikohet se *“zyrtaret publikë mund të paraqesin kërkesë për kompensim të dëmit nga shpifja apo fyera privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal”*.

Në rastin konkret padia është ushtruar nga paditësi Hasan Preteni derisa ishte Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe nga provat e administruara vërtetohet se deklaratat e paditësit në konferenca dhe medime të cilat ishin objekt lëndor i kishte dhënë në cilësinë e përfaqësuesit të institucionit.

Me dispozitat ligjore të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes nuk parashikohet mundësia e bartësve të funksioneve publike të padisin në cilësinë e tyre zyrtare, që do të thotë se përfaqësuesit e institucioneve nuk janë të mbrojtur me këtë ligj.

Përfaqësuesi i institucionit mund të kërkojë mbrojtje juridike si individ, por nuk mund të padisë në cilësinë e tij zyrtare. Në rastin konkret paditësi Hasan Preteni nuk ka arritur të argumentoj me asnjë provë se deklaratat e të paditurve kanë të bëjnë me shpifjen kundër tij si individ.

Pretendimet e paditësit se të paditurit kanë shpifur përmes deklaratave se Hasan Preteni në cilësinë e drejtorit të AKK-së “ka mbrojtur 7 deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës të cilët e kanë shkelur Ligjin nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë Publik, “ka bërë ndërhyrje dhe ka falsifikuar formularët për deklarinimin e pasurisë të paraqitur në AKK nga zyrtarët e lartë publik” nuk janë të bazuara, ngase një deklaratë e tillë paditësit Hasan Preteni i referohet si Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit.

Rrjedhimisht paditësi Hasan Preteni nuk ka arritur me asnjë provë të argumentoj faktin qenësor se të paditurit përmes deklaratave të tyre kanë cenuar personalitetin e tij, ngase të gjitha provat i referohen paditësit si përfaqësues i institucionit në rastin konkret në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Vendimin që paditësit t’i bartin shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), sipas së cilës të paditurve iu pranohen të gjitha shpenzimet për angazhimin e avokaitit edhe atë për përgjigje në padi shumën prej 312€ dhe për përfaqësime në katër seanca gjyqësore shumën prej 1081.60€ (270.40*4), shuma e përgjithshme në lartësi prej 1393.60€.

Nga arsyet e theksuara më lartë konform nenit 5 par.4 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, lidhur me nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1091/12, dt. 10.05.2018



KESHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

